



TV Dukagjini
Ermal PANDURI
Drejtor
Pejë

Ankesa Nr. 2017/43 KPM vs TV Dukagjini
Ref:1708/798/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/43 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV Dukagjini (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është televizion regjional me seli në Pejë. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM me datën 19 maj 2017 ka pranuar një ankesë nga z. Blerim Devolli ndaj Palës Përgjegjëset për emisionin Zona Express të titulluar “Devollistan”, të transmetuar me datën 30 prill 2017, përmes të cilës Pala Ankuese ka kërkuar mohimin dhe mundësinë e shprehjes në këtë emision për të gjitha fyerjet dhe sulmet personale dhe njollosjen e dinjitetit personal që i është bërë Palës Ankuese dhe kompanisë së tij.
4. KPM me datën 25 maj 2017, nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda tre (3) ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me të.
5. Pala Përgjegjëse është përgjigjur me datë 3 qershor 2017 duke theksuar se: “emisioni “Zona Express” është prodhim i Gazetës Express dhe nuk paraqet qëndrimet editoriale të Palës Përgjegjëse dhe se Pala Përgjegjëse ka të drejtën ekskluzive për emetim të këtyre produkteve pa pasur të drejtë dhe përgjegjësi në ndryshimin e përmbajtjes së tyre.” Po

ashtu, në sqarim Pala Përgjegjëse thekson se ka njoftuar opinionin publik me datën 9 maj 2017, ku ka dhënë sqarimin e lartcekur.

6. KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse me datë 8 qershor 2017 një shkresë sqaruese përmes të cilës i ka dhënë disa sqarime në lidhje me obligimet ligjore të Palës Përgjegjëse në raport me licencën për transmetim të lëshuar nga KPM-ja. Po ashtu, në bazë të Kushteve dhe Termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së dhe obligimeve tjera ligjore, Pala Përgjegjëse pavarësisht nëse programet janë të vetëprodhuara apo të blera, është përgjegjëse që këto programe të jenë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
7. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese dhe ka bërë monitorimin e emisionit ndaj të cilit është bërë ankesa. Në bazë të raportit të monitorimit të datës 11 korrik 2017, KPM ka gjetur se në emisionin “Zona Express” nga ana e Palës Përgjegjëse janë transmetuar sulme personale ndaj individëve, në këtë rast vëllezërve Devolli, po ashtu është përdorur gjuhë tendencioze ndaj kompanisë Devolli për të cilën nuk janë ofruar fakte lidhur me akuzat në emision, por vetëm janë dhënë opinione nga moderatori i emisionit lidhur me aktivitetet e tyre.

Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Kur transmetohen sulmet personale ndaj ndonjë personi, institucioni apo grupi, atij personi, institucioni apo grupi duhet t’i jepet një mundësi e drejtë për t’u përgjigjur menjëherë në të njëjtin program, nëse është e mundur, ose në rastin e parë të mundshëm. Nëse nuk mund të bëhet në këtë mënyrë, mundësia për t’u përgjigjur duhet t’i jepet në ndonjë program tjetër nën kushte të ngjashme.”

9. KPM pas analizimit të ankesës së Palës Ankuese dhe transkriptit të emisionit në fjalë ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dhënë detaje rreth aktiviteteve biznesore të kompanisë Devolli, duke dështuar të raportojë me saktësi dhe në mënyrë të paanshme, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues.”

10. Pala Përgjegjëse ka transmetuar sulme personale ndaj individëve, në këtë rast vëllezërve Devolli, duke përdorur gjuhë tendencioze ndaj kompanisë Devolli për të cilën nuk janë ofruar fakte lidhur me akuzat në emision, por vetëm janë dhënë opinione nga moderatori i emisionit lidhur me aktivitetet e tyre.
11. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar t’i ofrojë të drejtën e reagimit Palës Ankuese ashtu siç përcaktohet me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.”

12. KPM bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë veprime konkrete për të vepruar në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Vendimi

13. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura **kërkon** nga Pala Përgjegjëse në afat prej shtatë (7) ditësh të transmetojë reagimin e Palës Ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
14. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, sanksionon Palën Përgjegjëse me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) euro për shkelje të nenit 7, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 2, dhe nenin 10, paragrafin 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë